4 Z. Dëshmitar, kemi mbërritur në fund të dëshmisë tuaj.

5 Shoh që ZPS-ja është në këmbë.

6 Znj. Prokurore, e keni fjalën ju.

7 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres

8 znj. Kryegjykatëse.

9 Kemi një kërkesë për qartësim transkripti, mbase
10 dëshmitari mund të heqë kufjet, dëgjueset.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Preferoj që ta bëjmë ndryshe këtë. Preferoj që ta lëmë
13 dëshmitarin që të largohet.

14 Kështu që, znj. Sekretare ju lutem, a mund ta shoqëroni
15 dëshmitarin të dalë nga dhoma?

16 Z. Dëshmitar, do shoqëroheni jashtë nga aty ku jeni.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes
18 videolidhjes]

19 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 dëshmitari ka dalë nga dhoma.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Sa për të qenë të sigurtë për
24 terminologjinë. Në faqen 27 të transkriptit provizor të ditës
25 së sotme, rreshti 25, duket sikur dëshmitari i është referuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 41

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 "pavijoni numër 1". E ka përdorur fjalën "pavijon" edhe në
2 kontekste të tjera, kështu që do të donim që ai të sqaronte në
3 qoftë se bëhet fjalë për pavijonin 1 apo për ndërtesën 1.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
5 kuptoj. E kuptoj.

6 E shikoj Mbrojtjen që është në këmbë.

7 Avokat i Mbrojtjes, e keni fjalën ju.

8 Z. AOUINI: [Përkthim] E mbështesim këtë kërkesë, këtë
9 sqarim, sepse kjo është një çështje e cila do të dalë me
10 dëshmitarë të ndryshëm. Dhe do ishte mirë që ta sqaronim për
11 të gjithë se për çfarë bëhet fjalë për pavijon apo për
12 ndërtesë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit. Është përmendur në faqen 27, ju lutem a më
15 ndihmoni dot me rreshtin?

16 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po, sigurisht. Është faqja 27,
17 rreshti 25. Është fjala e pestë në atë rresht.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull.

20 Znj. Sekretare, ju lutem mund ta sillni dëshmitarin
21 përsëri në dhomë.

22 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

25 Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-10 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 42

Pyetje nga Trupi Gjykses

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, z. Dëshmitar.

3 Më dëgjon?

4 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

6 mirë. Kemi edhe një pyetje të fundit sa për t'u sqaruar, është

7 një pyetje e cila ka të bëjë me atë çfarë na thatë më herët

8 sot në përgjigje të pyetjes së bërë prej meje, së një prej

9 pyetjeve të bëra prej meje.

10 Ne po diskutonim, unë në fakt të pyeta në qoftë se

11 njerëzit ose personat e dyshuar i kishin të lidhur duart apo

12 jo dhe ju na thatë që:

13 "...ka mundësi, është e mundur që t'i kenë pasur të

14 lidhura, po unë kam harruar".

15 Këtë thatë ju. Dhe pastaj vazhduat më tej:

16 "Për shkak se kur silleshin ndonjëherë dërgoheshin në

17 zyrë nga komandantët dhe ndonjëherë i dërgonin në pavilionin

18 numër 1".

19 Ju lutem, a mund të na e sqaroni se çfarë doni të thoni

20 kur thoni "pavilioni numër 1"? Ku gjendej pavilioni numër 1?

21 PË. Pavilioni numër 1 gjindet me pavilion 4 që lidhet 15, 20

22 ma së shumti s'ka.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse

24 futesha nga porta kryesore në çfarë ane ishte pavilioni numër

25 1, ishte në të majtë apo në të djathtë apo përballë?

1 PË. Në të djathtë. Në të djathtë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e
3 kuptoj drejtë që kur thua "pavilioni 1" e ke fjalën për
4 ndërtesën ku dritaret ishin me hekura?

5 PË. Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
7 këtë e keni përmendur, e keni thënë që është edhe ndërtesa 1.
8 Për të njëjtën gjë bëhet fjalë apo jo? E saktë është kjo?
9 Bëhet fjalë për të njëjtën gjë?

10 PË. E saktë është.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A u
12 sqarua mjaftueshëm.

13 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.
14 Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, z. Dëshmitar.

17 Kemi mbërritur në fund të deklaratës tuaj. Dëshiroj t'ju
18 falënderoj për përpjekjet për të dhënë këtë dëshmi e cila
19 besoj se do të jetë e dobishme për ne, për Trupin Gjykses, në
20 mënyrë të tillë që të zbulojmë të vërtetën.

21 Faleminderit shumë.

22 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Respekt.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
24 kujtoj që nuk duhet të diskutoni dëshminë që keni dhënë
25 përpara kësaj Gjykate me asnjë. E kupton këtë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-10 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 44

Pyetje nga Trupi Gjykues

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, në rregull është.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë. Faleminderit dhe njëherë dhe tani do t'i kërkoj
4 Sekretares që t'ju shoqërojë dhe t'ju nxjerrë nga dhoma ku
5 jeni. Mbaruam. Faleminderit për kontributin.

6 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit edhe prej
7 juve.

8 [Dëshmitar largohet përmes video lidhjes]

9 [Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës
10 këshillohen]

11 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
12 dëshmitari dhe avokati i vetë janë larguar nga dhoma.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit, znj. Sekretare.

15 Kemi mbërritur këtu në fundin e dëshmisë së këtij
16 dëshmitar, pra, Dëshmitarit 10. Mund të vazhdojmë me
17 Dëshmitarin 11. Dhe këtë, në fakt, synojmë të bëjmë. E
18 diskutova me Njësinë e Menaxhimit dhe do kemi mundësi që të
19 fillojmë në orën 12.00 me dëshmitarin e radhës. Shoh ZPS-në që
20 e miraton.

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës
25 këshillohen]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 45

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
2 Faleminderit për pyetjen, po, po është llogaritur edhe kjo,
3 [REDAKTUAR]

4 Tani do të bëjmë një pushim prej një ore dhe do të
5 vazhdojmë në orën 12.00 me dëshmitarin e radhës. Do vazhdojmë
6 pra, në orën 12.00, do të vazhdojmë për një orë e gjysëm
7 pastaj do bëjmë pushimin e drekës dhe pastaj do vazhdojmë një
8 orë e gjysëm tjetër.

9 A ka ndonjë çështje që dëshirojnë palët të ngrenë në këtë
10 pikë?

11 Prokuroria.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Avokati i Viktimave.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam gjë për të thënë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Avokati Mbrojtës.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] E thatë nga ora 12.00 deri në orën
19 13.00 apo jo.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
21 Ndoshta u shpreha gabim po për këtë orar e kisha fjalën 12.00
22 deri në 13.

23 Këtu mbyllet seanca e paradites deri në orën 12.00.

24 --- Pauza fillon në orën 10.57

25 --- Seanca rifillon në orën 11.59

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
2 se keni ardhur përsëri.

3 Do të vazhdojmë me dëgjimin e dëshmisë së Dëshmitarit 11.
4 Së pari, po kontrolloj kush është i pranishëm nëse ka
5 pasur ndonjë ndryshim.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jemi të njëjtët me përjashtim
7 të z. Whiting.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
9 Mbrojtësi i Viktimave ka të njëjtën përbërje.

10 Dhe këtu te Mbrojtja shikoj keni ndryshuar vendet e
11 uljes.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kemi ndryshuar jo vetëm vendet,
13 duhet të them se është dhe znj. Francisca De Castro.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Sekretarja -- në vendin ku është dëshmitari -- Sekretare, të
16 lutem silleni dëshmitarin.

17 Z. Shala, më dëgjoni mirë?

18 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, shumë mirë ju
19 dëgjoj.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 [Dëshmitari hyn në gjykatë përmes videolidhjes]

23 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Të
24 nderuar Gjykatës, konfirmoj se të pranishëm në dhomë jemi unë
25 -- dhe dëshmitari.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 47

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Dëshmitar, mirëdita. Ka kaluar ora 12.00.

3 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Mirë se keni ardhur në Dhomat e Specializuara. Po shikoj
6 që më dëgjoni, a mund ta konfirmoni se më dëgjoni mirë?

7 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
9 mirë.

10 Z. Shala, e dëgjoni edhe ju dëshmitarin?

11 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e dëgjoj shumë mirë
12 bile. Ju faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit z. Shala.

15 Z. Dëshmitar, si jeni?

16 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirë, faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit. Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Z.

19 Dëshmitar më lejoni t'ju shpjegoj shkurtimisht masat mbrojtëse
20 të cilat janë miratuar për dëshminë tuaj.

21 Ju është caktuar një pseudonim, që do të thotë se nuk do
22 t'jua përmendim asnjëherë emrin, por do t'ju drejtohem si "z.
23 Dëshmitar" apo "Dëshmitar". Kështu publiku nuk do ta marrë
24 vesh se cili jeni, pra emrin tuaj.

25 Do t'ju shtrembërojmë pamjen e fytyrës dhe të zërit dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 48

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 askush që mund të ndjekë punimet jashtë kësaj salle nuk do ta
2 shohë fytyrën dhe nuk do të dëgjojë zërin tuaj të vërtetë
3 gjatë deponimit tuaj këtu.

4 Kur t'i përgjigjeni një pyetjeje që nuk nxjerrë
5 identitetin tuaj do ta bëjmë në seancë publike, pra publiku do
6 të dëgjojë ato që thuhet në këtë rast. Kur t'ju bëjnë pyetje
7 për të përshkruar diçka që lidhet konkretisht me ju, apo të
8 përmendin fakte që nxjerrin në pah identitetin tuaj, këtë do
9 ta bëjmë në atë që ne e quajmë seancë private. Dhe kjo do të
10 thotë se nuk do të transmetohet dhe se askush jashtë kësaj
11 salle gjyqi nuk mund të dëgjojë këto që thuhet këtu.

12 Nëse thuhet diçka gjatë një seance të hapur e cila mund
13 të nxjerrë në hap identitetin tuaj, apo mund t'ju
14 identifikojë, do të marrim masa që informacioni të mbrohet.
15 Dëshmia juaj do të transmetohet me një vonesë, dhe gjatë kësaj
16 vonese ne mund të heqim çdo informacion që mund të dëgjohet
17 apo të shihet, pra do ta heqim gjithashtu dhe nga transkripti
18 publik i procesit.

19 Këto masa mbrojtëse që sapo ju shpjegova, a janë të qarta
20 për ju z. Dëshmitar?

21 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Z. Dëshmitar, tani jeni thirrur të dëshmoni këtu përpara
25 Dhomave të Specializuara në çështjen Prokuroria kundër z.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 Pjetër Shala, për të ndihmuar Trupin Gjykues të dalë me një
2 vendim.

3 Pasi të keni bërë deklaratën solemne për të thënë të
4 vërtetën, do t'ju bëjnë pyetje Avokatët e Zyrës së Prokurorisë
5 së Specializuar. Janë njerëzit që janë të veshur me ato
6 mantelet ngjyrë lejla. Pastaj do t'ju bëjë pyetje pas Pala
7 Mbrojtëse, pra Avokatët e Palës Mbrojtëse, Mbrojtësi i Z.
8 Shala. Përpara ishte Mbrojtësi i Viktimave. Dhe nga ne
9 Gjykatësit e Trupit Gjykues.

10 Dua t'ju jap ca udhëzime për t'ju përgjigjur pyetjeve që
11 do t'ju bëjnë.

12 Z. Dëshmitar, të lutem dëgjoni me kujdes pyetjet. Kur nuk
13 i kuptoni mos ngurrtoni, kërkoni që t'jua përsërisin pyetjen.
14 Duam që të thoni të vërtetën, të na thoni atë që keni parë,
15 dëgjuar, jetuar vetë. Dhe nëse nuk i keni parë, dëgjuar vetë
16 ato që thoni, na thoni, na shpjegoni se si i keni mësuar.
17 Ndoshta nuk do t'ju kujtohen të gjitha hollësitë dhe kjo nuk
18 ka asnjë problem. Mos hamendësoni, mos sajoni nga mendja. Në
19 qoftë se nuk ju kujtohet na thoni "Nuk e di", "Nuk më
20 kujtohet".

21 Ju lutem përgjigjuni pyetjeve. Kur mund të nevojitet
22 sqarim, apo më shumë informacion, do t'ju kërkojnë të jepni
23 informacione të mëtejshme. Pra, fokusohuni, përqendrohuni tek
24 pyetjet.

25 Këto që sap ju thashë, z. Dëshmitar, i kuptuat?

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Do t'ju jap dhe disa këshilla praktike për gjatë
5 dëshmisë.

6 Gjithçka që ne themi këtu, z. Dëshmitar përkthehet dhe
7 incizohet, dhe ka rëndësi që të flisni pranë mikrofonit, të
8 flisni qartë dhe me ngadalë me qëllim që ne ta kuptojmë këtë
9 që thoni, sepse duhet të përkthehet nga përkthyesit.

10 Duhet të filloni të flisni vetëm pasi personi që ju ka
11 bërë pyetjen ta ketë mbaruar pyetjen. Pra, të mos flasim njëri
12 mbi tjetrin, sepse bëhet e pamundur që të përkthehet nga
13 përkthyesit. Kur ju bëhet një pyetje, ju lutem prisni pak
14 sekonda, pesë sekonda dhe pastaj jepeni përgjigjen. Kjo pauzë
15 e shkurtër është e rëndësishme sepse lejon përkthyesin të
16 përfundojë fjalinë.

17 Po e ngrita dorën kështu unë, pushoni, mos flisni më.
18 Ndonjëherë mund t'ju kërkojmë që të largoheni nga ajo dhoma ku
19 jeni tani bashkë me punonjësen e Gjykatës kur do të na duhet
20 të diskutojmë diçka që ka të bëjë me përmbajtjen e përgjigjeve
21 që keni dhënë.

22 Nëse keni ndonjë pyetje, nëse keni nevojë për ndonjë
23 pushim, apo doni t'i thoni diçka Trupit Gjykses, ngrini dorën.
24 Dhe në këtë mënyrë unë do ta kuptoj që ju dëshironi të flisni
25 dhe do t'ju jap fjalën.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 A janë të qarta këto që sapo ju thashë?

2 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Z. Dëshmitar, tani do t'ju kërkoj të bëni deklaratën
6 solemne për të thënë të vërtetën. Dhe dua t'ju them se është
7 vepër penale përpara kësaj gjykate të jepni dëshmi të rreme.
8 Është e qartë kjo?

9 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 mirë.

12 Sekretare, ndihmojeni Dëshmitarin, jepini deklaratën për
13 të bërë betimin solemn.

14 Z. Dëshmitar, mund ta lexoni tekstin që keni përpara.

15 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I ndërgjegjshëm për
16 rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore,
17 deklaroj solemnisht se do ta them të vërtetën, krejt të
18 vërtetën, dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë
19 asgjë për të cilën kam dijeni.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit z. Dëshmitar. Tani jeni nën betim për të thënë të
22 vërtetën.

23 Dhe tani mund të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 11,
24 duke filluar me pyetjet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

25 Z. Prokuror, keni dy orë e gjysmë për t'i bërë pyetje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 52

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 këtij dëshmitari. Nëse ka ndonjë ndryshim, njoftojeni Trupin
2 Gjykues.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ashtu do të bëjmë.

4 Faleminderit.

5 DËSHMITARI: TW4-11

6 [Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

7 Pyetje nga z. De Minicis:

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

9 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

10 PË. Mirëdita.

11 PY. Sikurse porsa jua shpjegoi Kryetarja e Trupit Gjykues,
12 për ju janë marrë masa mbrojtëse. Dhe sa herë që më duhet t'ju
13 bëj pyetje përgjigjja e të cilave mund të jetë identifikuese,
14 do të kërkoj të futem në seancë private. Dhe këto do ta bëj
15 tani sepse dua t'ju bëj disa pyetje për kontaktet personale.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
18 kalojmë në seancë private, ju lutem.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 53

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 54

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Z. Prokuror mund të vazhdoni.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 55

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 PY. Z. Dëshmitar, gjatë luftës, a keni qenë ndonjëherë anëtar
2 i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

3 PË. Jo.

4 PY. A keni qenë në Kosovë në kohën kur NATO filloi fushatën e
5 vet bombarduese në 1999?

6 PË. Po.

7 PY. Në Kosovë keni ndenjur deri në fund të luftës, apo jeni
8 larguar në ndonjë çast nga Kosova?

9 PË. Po, kam qenë deri më 27 prill në Kosovë, në 27 prill
10 1999, kam dalë me familjen në Shqipëri.

11 PY. Pa na dhënë ndonjë hollësi që mund t'ju identifikonte, a
12 mund t'i tregoni trupit gjykues se përse, çfarë ju shtyu ju
13 dhe familjen të largoheshit nga Kosova në prill 1999 dhe të
14 shkonit në Shqipëri?

15 PË. Po kishim presion prej paramilitarëve serbë, s'kishim
16 mishim [fonetikusht] dhe u detyrumë me ikë me pështu familjen.

17 PY. Ku shkuaat në Shqipëri në prill 1999, në ç'vend në
18 Shqipëri?

19 PË. Kemi qenë në Kukës.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të
21 kaloj në seancë private për disa pyetje që kanë të bëjnë me
22 hollësitë e vendit ku ka ndenjur dëshmitari, prandaj për të
23 qenë të sigurt, më mirë të kalojmë në seancë private.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
25 kalojmë në seancë private, ju lutem.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 56

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 57

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 58

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 59

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 60

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 61

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,

9 të nderuar Gjykatës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

11 Prokuror, ju lutem vazhdoni.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më është
13 mbyllur kompjuteri dhe nuk e kam më transkriptimin përpara. Ju
14 kërkoj një çast sa të fus fjalëkyçin në mënyrë që të mund të
15 më hapet përsëri kompjuteri.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull. Urojmë që të mos përsëritet prapë, në të kundërtën do
18 të më duhet që të thërrasim personat e njësisë së
19 informacionit dhe teknologjisë.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Z. Dëshmitar, ju kërkoj ndjesë
21 por kisha një problem të vogël me kompjuterin, që duket sikur
22 e zgjidha tani.

23 Kemi kaluar në seancë publike. Shpesh kalojmë nga seanca
24 publike në seancë private, në këtë seancë duhet të jeni të
25 kujdesshëm lidhur me atë që do thoni.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 62

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 Na thatë që pasi u futët në kerr me personin të cilin e
2 përshkruam apo e diskutuam pak më sipër, juve ju dërguan në
3 një lloj fabrike, kështu sikur thatë, kështu?

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dëshiroj që t'i tregohet
5 dëshmitarit një fotografi që i është treguar atij në një prej
6 intervistave të ZPS-së. Kështu që do të kërkoj që të shfaqet
7 në ekran, dokumenti me numër identifikimi ERN 059351-TR-ET
8 deri në 059350. Dhe dëshiroj që faqja e dytë t'i tregohet
9 dëshmitarit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
11 kjo është për t'i kërkuar dëshmitarit në qoftë se e ka parë
12 këtë dokument përpara apo jo.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
15 lutem vazhdoni, z. Sekretar.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem zmadhojeni pak, pra,
17 fotografinë që jepet në pjesën e sipërme të fletës, ju lutemi
18 zmadhojeni më tepër. Po, mjafton.

19 Të shikojmë pak edhe pjesën e sipërme për të vënë re
20 datën dhe nënshkrimin në majë ose në kokë të faqes.

21 PY. Pra ju na thatë që ju dërguan në një vend që dukej pak si
22 fabrikë. Këtë që jepet në këtë figurë, a e njihni këtë vendin,
23 e keni parë më përpara, ju thotë gjë kjo fotografi?

24 PË. Po, kur kam hy e kam vërtetu dhe kur kam dalë.

25 PY. Kjo është një fotografi që jua kemi treguar gjatë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 63

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 intervistës, pra më datë [REDAKTUAR]. Është shkruar diçka
2 sipër portës kryesore, është shkruar në shqip. A mund të na e
3 lexosh të lutem se çfarë është shkruar?

4 PË. Po, hyrja, hyrja kryesore.

5 PY. A ju kuptoj drejt që kjo është hyrja e vendit ku të
6 dërguan ty pasi të morën apo pasi u larguat nga [REDAKTUAR]
7 ku ndodheshit, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Faleminderit z. Dëshmitar.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
11 kërkoja që të hiqet kjo fotografi nga ekrani.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, z. Sekretar.

14 SEKRETARI I SEANCËS: [Mikrofoni i çaktivizuar]

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 PY. Z. Dëshmitar, e di që këto nuk janë kujtime të këndshme,
17 e di që ka kaluar shumë kohë. Megjithatë, do më duhet t'ju bëj
18 disa pyetje që kanë të bëjnë me përshkrimin e kohës që keni
19 shpenzuar atje.

20 A mund t'i thoni Trupit Gjykes përsëri se çfarë ndodhi
21 në momentin që ti e kalove portën, e kalove hyrjen, dhe
22 mbërrite në atë vend?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Dëshmitar, ju lutem kini parasysh që jemi në seancë publike,
25 kështu që kujdes me përmendjen e emrave që mund të thoni ose

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 64

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 informacione të tjera që mund të identifikojnë persona të
2 caktuar, kështu që kijini parasysht këtë.

3 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po. Mu më çuan drejt e
4 në dhomë në atë moment dhe aty kam qenë tanë kohën, në q'atë
5 dhomë.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

7 PY. Përpara se sa të çuan në atë dhomë, a t'u bë ndonjë
8 pyetje, domethënë përpara se të të dërgonin te dhoma, të bëri
9 njeri ndonjë pyetje?

10 PË. Jo, jo. Askush, asnjë pyetje s'ma kanë bë.

11 PY. Z. Dëshmitar, ka kaluar shumë kohë që prej atëherë.

12 Dëshiroj që t'ju pyes lidhur me diçka që ju keni thënë lidhur
13 me mbërritjen tuaj atje. Thjesht për t'ju bërë të mundur që të
14 kujtoni me sa më shumë saktësi që të jetë e mundur.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
16 rregull, vazhdoni.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem, a mund të shfaqet në
18 ekran dokumenti SITF00020018 deri në 20028 RED3.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Prokuror. Për herë tjetër kur të jepni referencat, ju lutem
21 mos përmendni data. Sepse duam që të jemi të sigurt që nuk del
22 ndonjë informacion që nuk duhet të dalë.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit për kujtesën, e
24 nderuar Gjykatëse.

25 PY. Dokumenti që do të shfaqet në ekran ka të bëjë me një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 65

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 dëshmi që ju keni dhënë në të shkuarën. Nuk do themi as datën
2 kur e keni dhënë dëshminë, as ku e keni dhënë dëshminë.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Një çast, të nderuar Gjykatës.

4 Në versionin në shqip të këtij dokumenti, të nderuar
5 Gjykatës, që do të shfaqet tani ERN-ja është SITF00020058 deri
6 00020264 [sipas përkthimit]. Dëshiroj që të shfaqet faqja 32
7 në gjuhën angleze, dhe faqet 5 dhe 6 në versionin në shqip.
8 Faqen 31 në anglisht, ju lutem.

9 PY. Në të shkuarën, z. Dëshmitar, ju keni dëshmuar se me të
10 mbërritur aty, pra që u dërguat te ky shtabi, keni thënë që ju
11 kanë çuar në një zyrë për rreth 30 minuta.

12 Dhe në versionin anglisht të shkojmë te faqja 32. Vijon
13 më tej kur thoni që:

14 "Së pari, më mbajtën në zyrë, pastaj më dërguan diku
15 tjetër," dhe nga kjo dëshmi ne e kuptojmë që ky vendi tjetër
16 ishte vendi ku ju qëndruat për ca kohë.

17 A të kujtohet që të dërguan në një zyrë përpara se sa të
18 dërgoheshe në këtë vendin ku qëndrove më gjatë?

19 PË. Kjo -- më falni -- kjo zyrë ka qenë në hymje të portës,
20 ku më janë marrë lidhëset e këpucëve. Dhe prej q'asaj dhomës
21 deri në q'atë drejtim, më kanë çu në dhomë ku kam ndejtë tanë
22 kohën.

23 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Përsëri, ndonjëherë mund t'ju
24 bëj pyetje për të sqaruar gjëra të cilat mbase janë ndryshe
25 nga çfarë keni dëshmuar në të shkuarën, sepse ka kaluar shumë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 66

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 kohë. Thjesht qëllimi është që ta kemi sa më të saktë të jetë
2 e mundur informacionin.

3 A të kujtohet që ndërkohë që ishit në dhomë dhe të ishin
4 marrë lidhëset e këpucëve, a të është bërë ndonjë pyetje në
5 momentin që shkuat në dhomë? Domethënë pasi të morën lidhëset
6 e këpucëve?

7 PË. Jo, nuk më kanë bërë kurrënjifarë pyetje.

8 PY. Na thatë që pasi kaluat në këtë dhomën afër hyrjes për
9 pak çaste, të dërguan në një dhomë tjetër.

10 Nga hyrja, nga porta kryesore që identifikuat, në
11 fotografinë që ju treguam më herët, për të shkuar te dhoma ku
12 ke qëndruar i mbajtur. Domethënë çfarë drejtim duhej të
13 merrnit, duhej të shkonit në të djathtë, në majtë, do të
14 shkonit përballë? Domethënë momenti kur futesh te porta
15 kryesore. Çfarë drejtimi duhet të marrësh për të shkuar tek
16 vendi ku të kanë mbajtur.

17 PË. Vendi -- në të majtë ka qenë, në drejtim, por dhoma ka
18 qenë në anën e majtë prej hymjes.

19 PY. [Nuk ka përkthim]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Prokuror a mund ta heqim nga ekrani deklaratën e mëparshme?

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, patjetër.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Sekretar, ju lutem a mund ta hiqni deklaratën?

25 Ju lutem vazhdoni.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 PY. Pra, thatë që kur futesh ndërtesa ishte në të majtën
3 tënde? Domethënë futesh tek hyrja, tek porta kryesore, dhe kur
4 futesh në portën kryesore, nga cila anë mban, çfarë drejtimi
5 mban? Në të majtë, në të djathtë?

6 PË. Drejtimi drejt, por ajo dhoma ka qenë në anën e majtë.
7 Prej drejtimit kur kam ecë prej te hymja.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund t'i
9 kërkoj Sekretarit që të shfaqë në ekran ...

10 PY. Ju kërkoj ndjesë, z. Dëshmitar, një çast.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
12 ju kërkojmë ndjesë, mund të vazhdoni.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretarit që
14 të japë, të shfaqë në ekran, intervistën që kemi pasur me
15 dëshmitarin në [REDAKTUAR] Është dokumenti me ERN 108858-TR-
16 ET, Pjesa 1 RED, faqet 4 dhe 5.

17 PY. Në atë kohë, kur kemi bërë intervistën me ju --

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë të nderuar
19 Gjykatës se nuk dhashë numrin e referencës. Në versionin shqip
20 prapë bëhet fjalë për faqet 4 dhe 5.

21 PY. Do t'ju them atë çfarë na keni thënë ju në 2019. Në vitin
22 2019 ju keni thënë që:

23 "Kur futesh tek porta kryesore, pastaj kthehesh pak
24 djathtas, dhe aty është ajo ndërtesa ku ishte dhoma".

25 "Pra, kthehesh pak djathtas te porta kryesore?"

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 68

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 "Pra, domethënë në të djathtë pasi hyn te porta kryesore.
2 Tek porta kryesore në të majtë, brenda në oborr në të majtë".

3 Pra, në faqen 5 e kemi sqaruar këtë çështje. Në 2019, ju
4 keni thënë që ishte në të djathtë kur hyn te porta kryesore.

5 "Pra, ti kthehesh pak djathtas dhe ndërtesa është të
6 majtë."

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi
8 në faqen 5?

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, jemi në faqen 5, në
10 rreshtat 7 deri në 11.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
12 për Sekretarin në mënyrë që ta zmadhojë, të na e tregojë këtë
13 pjesë.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

15 PY. Pra, ndërkohë që ne po përpiqeshim që të sqaronim se ku
16 gjendej kjo dhomë, ju thoni që futesh, kthehesh në të djathtë,
17 dhe ndërtesa është në të majtë.

18 A ka kuptim kjo, sa i takon vendndodhjes së kësaj
19 ndërtese për të cilën po flasim?

20 PË. Po, të vërtetën me thënë, prej hymjes, te hymja kur kanë
21 dalë, ka qenë oborr. Por kemi ecë djathtas edhe pak përballë
22 në të majtë ka qenë ajo, sa e mbaj mend unë në të majtë ka
23 qenë ajo dhoma ku kam hy.

24 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani e kam të qartë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

1 mund t'i heqim deklaratat nga ekrani?

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, mund t'i heqim.

3 PY. Të kujtohet nëse ndërtesa kishte një kat apo më shumë
4 kate se sa kaq?

5 PË. Sa më kujtohet mu, për atë moment kur kam hy ka qenë
6 njëkatëshe, qe atë mbaj mend.

7 PY. Kush ju udhëzoi për të shkuar te kjo ndërtesa? Ishin të
8 njëjtët persona që ju kërkuan që t'i ndiqnit dhe të shkonit me
9 ta në kamp apo ishin persona të tjerë?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 lutem, mos përmendni, mos thoni emra këtu.

12 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Jo. Ka qenë një person
13 civil i cili më ka udhëzuar, më ka çu deri te dera.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

15 PY. Pra ti the që të çuan ose të udhëzuan deri te dera. A
16 mund të na përshkruani se çfarë pamje kishte ndërtesa brenda?
17 Pra pasi u fute te dera, si dukej, çfarë pamje kishte ndërtesa
18 brenda?

19 PË. Ndërtesa mbrenda kishte një korridor të vogël dhe një
20 dhomë.

21 PY. Kjo dhoma ishte në të majtë, ishte drejt sapo futeshe apo
22 ishte në të djathtë të korridorit? Domethënë kur hyje brenda
23 ndërtesës, ku gjendej, në çfarë ane gjendej dhoma?

24 PË. Si hyn në korridor, derën në të majtë e ka pasë.

25 PY. Kur futeshe te kjo dhoma në të majtë, në këtë dhomën në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 70

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 të majtë ke qëndruar ti gjatë kohës që ke qenë aty në fabrikë?

2 PË. Po, tanë kohën kam qenë.

3 PY. Për sa kohë qëndruat aty në atë dhomë, z. Dëshmitar?

4 PË. Deri kur është çlirë Kosova atëherë në fund kam dalë.

5 S'mbaj mend, afër një muaj, një muaj e dhjetë ditë, një muaj e
6 pesë ditë, nuk e di.

7 PY. Na përshkruat se çfarë pamje kishte kjo ndërtesa me një
8 kat. Thatë, domethënë, që kishte një korridor, kishte edhe një
9 dhomë të majtë. Kjo është dhoma ku ju keni qëndruar për
10 pothuajse një muaj. A mund t'i përshkruani Trupit Gjykues se
11 çfarë ju kujtohet lidhur me mënyrën se si ishte organizuar kjo
12 dhomë, domethënë, çfarë planimetrie kishte? Ndonjë hollësi,
13 ndonjë gjë tjetër që të kujtohet lidhur me dhomën ku keni
14 qëndruar.

15 PË. Dhoma ishte me një dritare. Diku 4 me 4, apo 4 me 3.5,
16 q'aty pari. E shtrume me beton.

17 PY. Atëherë, kjo dera që kur hyje që futeshe në korridor, dhe
18 që shkonit te kjo dhoma në të majtë. Dhoma ishte e mbyllur, e
19 kyçur kur futeshe ti në të majtë? Ishte e mbyllur dhoma?

20 PË. Po, dhoma ishte e mbyllur.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
22 që t'i tregoj një fotografi dëshmitarit. Dëshiroj që të
23 shfaqet dokumenti me numër identifikimi ERN 108852-TR-ET deri
24 108857 RED.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 71

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 çfarë qëllimi e kërkonti që të tregohet kjo fotografi?

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të tregoj një fotografi që i
3 është treguar në një intervistë të mëparshme dëshmitarit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua që të shfaqet faqja 5 e
7 këtij dokumenti.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Sekretar, ju lutem shfaqeni këtë fotografi.

10 Z. Prokuror, ka pak minuta për të shkuar ora 13.00, që ta
11 dini. Faleminderit.

12 Z. DE MINICIS: [Mikrofoni çaktivizuar]

13 Me ç'kuptoje kjo fotografi nuk transmetohet për publikun,
14 kështu?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
16 nuk duhet të transmetohet. E kemi marrë parasysh këtë kërkesë
17 tuajën.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

19 PY. Kjo fotografi....

20 Nuk e di në qoftë se mund ta zmadhoni pak z. Sekretar.
21 Pak më sipër. Thjesht zmadhoheni pak.

22 PY. Kjo ndërtesa njëkatëshe që jepet në këtë fotografi, a e
23 njihni këtë ndërtesë? A e keni parë më përpara, jeni në
24 gjendje t'i thoni Trupit Gjykses në qoftë se e keni parë këtë
25 ndërtesë më përpara?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 72

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Të
2 nderuar Gjykatës, nuk e di në qoftë se mund të na dëgjoni apo
3 mund të na shihni sepse patëm një shkëputje dhe as nuk ju
4 dëgjuam dot dhe as nuk ju pamë dot.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ende
6 e kemi të paqartë figurën.

7 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Ju
8 dëgjojmë qartë tani, shikojmë gjithashtu edhe fotografinë që
9 transmetohet në ekran.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 shohim qartë tani. Çfarë është gjëja e fundit që thamë ne që
12 dëgjuat juve, domethënë, nuk e di nëse mund të na e sqaroni
13 këtë?

14 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim]
15 Prokurori po e pyeste dëshmitarin lidhur me këtë ndërtesë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Z. Prokuror ju lutem a mund ta bëni edhe një herë
18 pyetjen?

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase kjo
20 mund të jetë përjashtim ose mund ta bëjmë edhe më vonë këtë
21 pyetje, sepse kemi një tjetër fotografi që është pjesë e
22 dokumenteve që kemi dorëzuar lidhur me këtë dëshmitar. Pra,
23 është e njëjta fotografi, e njëjta ndërtesë, por është me
24 ngjyra, është më e qartë. Kështu që dua t'ju kërkoj në qoftë
25 se do të na lejoni që t'i tregojmë atë fotografi dëshmitarit,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 73

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 jo këtë, mbase pas pushimit. Mbase duhet pyetur edhe Mbrojtja
2 në qoftë se kanë ndonjë kundërshtim lidhur me këtë apo jo.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
4 t'i jap fjalën Mbrojtjes në qoftë se kanë ndonjë kundërshtim
5 për përdorim një fotografi më të qartë se fotografia që kemi
6 përpara. Është një fotografi që është dorëzuar si pjesë e
7 materialeve për këtë dëshmitar.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
10 miratojmë këtë kërkesë dhe mund ta bëjmë pyetjen lidhur me
11 këtë pyetje pas pushimit.

12 Atëherë propozimi juaj është që të përfundoni marrjen në
13 pyetje të dëshmitarit tani, të bëjmë një përditësim të
14 materialeve të renditura si pjesë e dokumenteve që do të
15 përdoren për këtë dëshmitar, dhe pastaj mund të vazhdojmë më
16 tej me marrjen në pyetje të dëshmitarit edhe transmetimin ose
17 shfaqjen e një tjetër fotografie.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim. Pushimi do të
21 zgjasë deri në orën 14.30. Kemi një orë e gjysmë pushim. Pas
22 pushimit të drekës, ZPS-ja do të vazhdojë me marrjen në pyetje
23 deri në fund të ditës.

24 Tani do t'i kërkoj Sekretares që t'ju nxjerrë nga dhoma
25 ku jeni, edhe ju bëftë mirë dreka. Do shihemi përsëri pas

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 74

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 pushimit të drekës.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes

3 videolidhjes]

4 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Të

5 nderuar Gjykatës, dëshmitari ka dalë nga dhoma.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit znj. Sekretare.

8 A ka ndonjë gjë që doni ta diskutoni përpara se sa të

9 bëjmë pushimin e drekës? ZPS-ja ka ndonjë gjë?

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Mbrojtja e Viktimave?

13 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Mbrojtja e të Akuzuarit?

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

18 mirë. Do të takohemi atëherë në orën 14.30.

19 Seanca ndërpritet këtu.

20 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

21 --- Seanca rifillon në orën 14.30

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

23 se keni ardhë përsëri. Të shoh nëse ka ndonjë ndryshim në

24 ekipet përkatëse. Prokuroria nuk ka ndryshim. As për

25 Mbrojtësin e Viktimave. As për ekipin e Mbrojtjes.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 75

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 Në rregull. Z. Shala është i pranishëm përmes
2 videolidhjes.

3 Z. Shala, më dëgjoni?

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuar. Ju
5 ndëgjoj shumë mirë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë.

8 Po, mund të vazhdojmë me pyetjet kryesore të Zyrës së
9 Prokurorisë së Posaçme. Tani, i lutem Sekretares, të sjelli
10 dëshmitarin në dhomë.

11 [Dëshmitar vijon dëshminë përmes
12 videolidhjes]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
14 se jeni kthyer, z. Dëshmitar. A më dëgjoni mirë?

15 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, mirë ju ndëgjoj.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull.

18 Z. Shala, e dëgjoni zërin e dëshmitarit?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, shumë mirë e
20 ndëgjoj.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 rregull. Atëhere mund të vazhdojmë.

23 Por sa për ta ditur, z. Dëshmitar, tani jemi në seancë
24 publike, pra, ju lutem tregohuni i kujdesshëm të mos nxirrni
25 ndonjë informacion identifikues lidhur me personin tuaj. Tani

1 do t'ia jap fjalën Prokurorisë, z. Prokuror.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar.

3 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Përpara se të ndërprisnim punën
4 për drekë, isha gati për t'ju treguar një fotografi, për të
5 cilën dua t'ju bëj disa pyetje.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tani kemi një version pak më të
7 mirë të së njëjtës fotografi dhe me lejen e Gjykatës do ta
8 vëmë në ekran. Numri është ERN 074390 deri në 074391.

9 Dua që të shohim, t'i tregohet dëshmitarit kjo faqja e
10 parë këtu.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Vazhdoni.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe pak ngriheni më lart. Në
14 rregull.

15 PY. Z. Dëshmitar, e shikoni këtë fotografinë që tregon një
16 ndërtesë?

17 PË. Po.

18 PY. A ju duket e njohur kjo ndërtesa? E njihni?

19 PË. Po, e njoh.

20 PY. Çfarë është kjo ndërtesë?

21 PË. Kjo ndërtesë aty, në dhomën e parë ku po shifet, q'aty
22 kam qenë.

23 PY. Nëse ju kuptoj drejtë, kjo është ndërtesa ku ju sollën
24 pasi ju morën nga fabrika e metaleve?

25 PË. Jo. Q'aty brenda ka qenë kjo. Në q'atë hymje.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 77

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 PY. Ju mbajtën në një dhomë brenda kësaj ndërtese?

2 PË. Po, më duket se po. Më duket se po.

3 PY. Faleminderit. Është, nuk duket e gjithë ndërtesa, duket
4 një pjesë, por nga pjesa që duket në këtë fotografi e kësaj
5 ndërtese, e shihni dot vendin ku është hyrja në të, ku ndodhet
6 hyrja e shihni? Nëse po, unë do t'i lutesha Sekretares t'ju
7 jepte një diçka për të shkruajtur dhe aty ku është hyrja, mund
8 t'i bëni një rreth, ta rrethakoni.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] I
10 dhamë dëshmitarit fotografinë dhe një stilolaps me ngjyrë blu.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
12 keni një kopje të shtypur të kësaj fotografie. Ja keni dhënë
13 dëshmitarit bashkë me një stilolaps, me ngjyrë blu.

14 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim]
18 Dëshmitari po bën një rreth.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E shikoj që është bërë një
20 rreth aty në fotografi.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Dëshmitari ka bërë një shenjë tek ndërtesa, do të thosha, në
23 anën e djathtë të saj, pas dritares së dytë në krahun e
24 djathtë. Këtë përshkrim mund të jap unë.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do ta paraqesim si provë

1 materiale.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
3 fusim në programin *Legal Workflow* më vonë.

4 Vazhdoni.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sa për ta sqaruar, z.

6 Dëshmitar. Më herët na thatë që kishte një derë ku ishte hyrja
7 e ndërtesës, pastaj ishte një korridor dhe dhoma ku ju mbajtën
8 ishte në krahun e majtë të korridorit. Tani ju shënuat derën
9 pas së cilës vinte korridori. Kështu ka qenë?

10 PË. Po.

11 PY. A kishte ndonjë roje aty jashtë, jashtë hyrjes në kohën
12 që ju mbaheshit i ndaluar brenda?

13 PË. Po.

14 PY. Nga e dini ju që kishte një roje që qëndronte jashtë
15 derës?

16 PË. Po kur kishim nevojë për me marrë ujë, na çilke derën me
17 dal me marrë ujë.

18 PY. Ishit i lirë të hynit e të dilnit nga dhoma në atë
19 ndërtesë, z. Dëshmitar, apo për këtë duhej t'i thoshit rojës?

20 PË. Jo, i thoshim rojës. Roja na çilke derën.

21 PY. Jemi ende në seancë publike, ju e keni përshkruar vendin
22 ku ju kanë mbajtur. Ju treguam dhe një foto. Tani do t'ju pyes
23 për njerëz të tjerë të cilët mund të kenë qenë me ju në dhomë.

24 Dua t'ju bëj nja dy pyetje në seancë publike, ju lutem mos e
25 nxirrni identitetin e tyre. Pastaj do të kalojmë në seancë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F579
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 79
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 private për detaje të tjera.

2 Tani pyetja që kam për ju është: Kur mbërritët aty, kur
3 ju sollën në atë ndërtesë, a kishte njerëz të tjerë në dhomën
4 ku u mbajtën dhe juve?

5 PË. Po.

6 PY. A ju kujtohet afërsisht sa njerëz kanë qenë?

7 PË. Po përafërsisht shtatë-tetë vetë. Nuk muj me i ngje, po
8 përafërsisht.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kaq mund të them në seancë
10 publike, të nderuar Gjykatës. Tani i kërkoj që të futemi në
11 seancë private.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund ta heqim edhe atë
15 fotografinë nga ekrani.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
17 morëm shënim.

18 Sekretar, hiqeni fotografinë dhe të kalojmë në seancë
19 private për vazhdimin e pyetjeve.

20 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F579

21 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Vazhdoni, z. Prokuror.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F579
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 80
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 PY. Dëshmitar, tani jemi në seancë private, kështu që mund të
2 flasësh dhe për detaje. [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]. Dhe do përpigëm që të bëj
4 sa më pak pyetje dhe ju falënderoj për durimin që keni treguar
5 dhe për gatishmërinë për t'u përgjigjur.

6 Ju na thatë se ishin afërsisht shtatë apo tetë veta pasi
7 ju çuan në dhomë. A ju kujtohet ndonjëri prej tyre kush ishte,
8 identiteti i tij?

9 PË. Po, tre persona i kam njoftë.

10 PY. Cilët ishin këta tre persona që i keni njohë?

11 PË. Këta kanë qenë romë, po kanë qenë muzikantë. Në bazë të
12 muzikave, si traditave tona dasme, i kam pasë njoftë.

13 PY. E di nga ishin? Nga cila pjesë e Kosovës ishin? Nga
14 Kosova ishin?

15 [REDAKTUAR]

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua t'i tregoj dëshmitarit një
17 fotografi, që ka disa persona aty. Dhe, me lejen tuaj, dua t'i
18 bëj pyetje dëshmitarit. Prandaj ju lutem paraqisni në ekran
19 këtë provë materiale që ka numrin 059350. Dua që ta paraqisni
20 në faqen 8 këtë dokument.

21 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë personin që tregohet në
22 këtë fotografi?

23 PË. Po.

24 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses se cila është kjo?

25 PË. Ky është një pi vëllaznëve, dy vëllazën çka kanë qenë, ma

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 81

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 i vogli.

2 PY. Është një njerëzit që sapo i thatë Gjykatës se ishin

3 muzikantë?

4 PË. Po.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund ta heqim fotografinë.

6 Mbaruam punë me të.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Sekretar, hiqeni.

[Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 82

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 83

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 84

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 85

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 86

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

[Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F579

11 PY. Pra, tani e përcaktuar që personat që ishin të ndaluar me

12 ju, domethënë, nga ata që qëndronin në një dhomë me ju, ishin

13 tre muzikantë, kishim [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kryetare e Trupit Gjykses, mund

17 ta hiqni fotografinë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

21 PY. Kanë kaluar shumë kohë - kanë kaluar mbi 20 vjet - por a

22 njohët ju ndonjë person tjetër ndërmjet atyre njerëzve që

23 ishin së bashku me ju në atë dhomë? Ndoshta jo me emër, por

24 ndonjë hollësi tjetër, a keni njohur ndonjë person tjetër që

25 ka qëndruar me juve në atë dhomë gjatë asaj kohe?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F579
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 87
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 PË. Jo, nuk kam njoftë asnjë tjetër.

2 PY. Me lejen e Gjykatës, do të përpiqem t'ju ndihmoj për të
3 rifreskuar kujtesën me një hollësi që e kujtonit [REDAKTUAR]
4 gjatë intervistës që patët me ne.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
6 lutem, vazhdoni.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem, a mund të shfaqet
8 deklarata e dhënë nga dëshmitari [REDAKTUAR] me numër
9 identifikimi ERN SITF00013047 deri në SITF00013060 RED4. Faqja
10 10.

11 Versioni në gjuhën shqipe i këtij dokumenti i cili
12 gjendet në faqen 10, është dokumenti me numër identifikimi
13 SITF00013075 deri në SITF00013088 RED5. Në faqja 10. Në
14 rregull.

15 PY. Z. Dëshmitar, në atë kohën, pra, kur ju ka pyetur
16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR] - ju ka pyetur:

18 "Ti na përshkrove tre romët dhe [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR] A mund të përshkruani dhe ndonjë person tjetër në
20 qeli?"

21 Përgjigja që keni dhënë ju është kjo:

22 "Kishte dhe të tjerë. Njëri prej tyre [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR] Ndenji aty shkurt dhe

24 pastaj është liruar".

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F579
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 88
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 PË. Po, më kujtohet që ata shokët bisedojshin mes veti dhe
4 thanë [REDAKTUAR] Unë direkt me
5 të nuk kam bisedue.

6 PY. Gjatë kohës që ke qëndruar i ndaluar në atë dhomë së
7 bashku me këta personat që na përshkruat, a vutë re në qoftë
8 se kishte ndonjë dhomë tjetër në të njëjtën ndërtesë ku
9 mbaheshin persona të tjerë, pra, a kishte dhomë tjetër, përveç
10 asaj ku ishit ju, ku mbaheshin njerëz të tjerë?

11 PË. Nuk kam vërejt. Nuk di gjë. S'kam pa dhoma tjera.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani
14 dëshirojmë që të kalojmë përsëri në seancë publike. Besoj se
15 është momenti për të kaluar në seancë publike.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull. Dhe t'i heqim nga ekrani dokumentet?

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Do të mundohem të më
19 kujtohet dhe t'ju them për herë tjetër për t'i hequr
20 dokumentet nga ekrani.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 rregull.

23 Sekretar, a mund të na kaloni në seancë publike, ju
24 lutem?

25 ~~{Seancë e hapur}~~

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 89

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
2 të nderuar Gjykatës.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit, z. Sekretar.

5 Z. Dëshmitar, jemi kthyer prapë në seancë publike. Sa për
6 ta ditur. Kështu që tregojini kujdes gjërave që do thoni.

7 Z. Prokuror, e keni përsëri fjalën ju.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
9 Gjykatëse.

10 PY. Z. Dëshmitar, po ecim mirë me pyetjet. I kam përfunduar
11 thuajse gjysmën e pyetjeve që kisha planifikuar për juve. Jeni
12 i lodhur, z. Dëshmitar, apo mund të vazhdojmë në tej me
13 pyetjet?

14 PË. Jo, do vazhdojmë.

15 PY. Faleminderit. E vlerësojmë shumë këtë. Megjithatë në
16 qoftë se në ndonjë çast ndihesh i lodhur apo keni nevojë për
17 ndonjë pushim na thoni këtë gjë, thojini Trupit Gjykses për
18 këtë gjë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
20 Dëshmitar, nëse keni nevojë për një pushim ose nëse do të
21 preferoni që të vazhdojmë me pyetjet më vonë, për shembull,
22 nesër mund ta bëjmë këtë, na e thuaj në qoftë se e ndjen
23 kështu.

24 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Për mu mund ta
25 vazhdojmë, ta vazhdojmë sot.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
2 mirë. Do vazhdojmë atëherë.

3 Z. Prokuror, fjala për ju.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 PY. Tani që diskutuam vendin ku jeni mbajtur i ndaluar dhe që
6 diskutuam personat me të cilët ke qëndruar në atë vend,
7 dëshiroj që të diskutojmë lidhur me kushtet e ndalimit tuaj,
8 pra, në çfarë kushtesh jeni ndaluar ju dhe personat e tjerë që
9 ishin bashkë me ju.

10 Pyetja e parë është kjo: Ku flije ti dhe të ndaluarit e
11 tjerë që ishin në të njëjtën dhomë me ty?

12 PË. Në dysheme kemi pasë fjetë, në tokë.

13 PY. Prej çfarë ishte dyshemeja, ça materiali ishte dyshemeja?

14 PË. Po beton edhe kemi pasë shiltet, qysh t'ia them, qebe.

15 PY. A mund të na e përshkruash më me saktësi sesi ishin këto
16 shiltet, na e përshkruaj një çik si janë shiltet?

17 PË. Shilte të holla prej syngjeri edhe ka një qebe.

18 PY. Na thatë më herët që për të dalë nga ajo dhomë ku ishit
19 ndaluar, për shembull, për të pirë ujë, duhej që t'i kërkonit
20 rojës t'u sillte ujë. A ishte e mundur për juve që të dilnit
21 pak jashtë, që të shtriqeshit pak, të merrnit ajër të freskët
22 apo të qëndronit jashtë në oborr gjatë kohës që ishit të
23 ndaluar aty?

24 PË. Jo, vetëm dilnim me marrë ujë edhe u kthenim prapë në
25 dhomë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 91

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 PY. A të kujtohet nëse ndërmjet atyre personave që ishin të
2 ndaluar bashkë me ty, a kishte njerëz, a kishte persona që
3 detyroheshin që të dilnin nga dhoma për arsye të tjera, pra,
4 përveç se të shkonin në tualet apo që të mbushnin ujë për të
5 pirë?

6 PË. Jo. Përveç kur i merrnin në pyetje.

7 PY. Faleminderit. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me marrjet
8 në pyetje pak më vonë. Por përpara sesa të bëj këtë pyetje, a
9 të kujtohet në qoftë se ndokush detyrohej që të dilte nga
10 dhoma për të punuar, për të bërë ndonjë punë?

11 PË. Po. Dilnin vëllezërit ata romët.

12 PY. A thanë ata ndonjëherë ndonjë gjë, a bënë ndonjë koment,
13 a dhanë ndonjë hollësi lidhur me punën që detyroheshin që të
14 bënin?

15 PË. Jo. Vetëm e pastrojshin oborrin, atë krugën ku kemi qenë.
16 Vetëm atë e pastrojshin q'atë dhe u kthejshin prapë.

17 PY. Nga e di ti që pastronin atë oborrin, nga e di ti këtë
18 gjë?

19 PË. Po na tregojshin kur ishin brenda në objekt.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Prokuror, në rreshtin 81, paragrafi 11, përmendët tualetet.
22 Bëra një kontroll të shpejtë por --

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë, e nderuara
24 Gjykatëse, është gabimi im.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

1 ta bëni këtë pyetje gjithsesi.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

3 PY. Z. Dëshmitar, a mund të largoheshit nga dhoma ku
4 mbaheshit i ndaluar nëse kishit nevojë që të shkonit në banjo,
5 në tualet?

6 PË. Po. Sa herë kishim nevojë dilnim.

7 PY. A duhet që të kërkonit leje nga roja për të shkuar në
8 tualet?

9 PË. Po.

10 PY. Z. Dëshmitar, a keni parë vetë me sytë tuaj ndonjë lloj
11 keqtrajtimi në dhomën ku keni qenë i ndaluar?

12 PË. Po.

13 PY. A mund t'i përshkruani Trupit Gjykues llojet e
14 trajtimeve, keqtrajtimeve që keni parë me sytë tuaj ndërkohë
15 që qëndronit i ndaluar aty?

16 PË. Po i kanë, vëllazrit romë ma tepër i kanë rrahur me
17 shufër gome. Dhe mu personalisht vetëm njëherë më kanë rrahë.

18 PY. Kush i kryente këto rrahje, kush i ka bë këto rrahje, të
19 kujtohet?

20 PË. Nuk kemi mujt me këqyr. I kemi kthye ka zidi e ashtu që
21 s'i kemi pa kush ka qenë edhe kush s'ka qenë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Prokuror, dëshiroj që të kalojmë ndoshta për pak kohë ose
24 ndoshta për pak më gjatë në seancë private për të diskutuar
25 diçka.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F579
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 93
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 A mund të na kaloni në seancë private, z. Sekretar?

2 ~~{Seancë private}~~ {Seancë e hapur} Riklasifikuar në
bazë të F579

3 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë private,
4 të nderuar Gjykatës.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit, z. Sekretar.

7 Po përmendim dhe po themi që ishin vëllezër, në dosjen
8 paraprahe fakti që këta dy persona ishin vëllezër është
9 redaktuar. Thjesht duam që të jemi të sigurtë, në qoftë se ky
10 është informacioni që doni të jetë publik apo jo.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne do
12 shikojmë versionin publik të dosjes paraprahe dhe do shikojmë
13 në qoftë se ka redaktime të cilat nuk janë të nevojshme që të
14 qëndrojnë më në atë dokument.

15 Një çast, ju lutem. Këta persona nuk janë dëshmitarë në
16 këtë çështje gjyqësore dhe nuk janë objekt i ndonjë mase
17 mbrojtëse, kështu që nuk shohim ndonjë arsye se pse duhet
18 redaktuar ose duhet hequr ky informacion në këtë fazë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
20 qartë, por thjesht donim që të siguroheshim që e kishit
21 parasysh këtë gjë.

22 Komente nga palët? Jo, nuk ka.

23 Në rregull. Z. Sekretar, na kaloni në seancë publike
24 përsëri, ju lutem.

25 ~~{Seancë e hapur}~~

1 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
2 të nderuar Gjykatës.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Z. Prokuror, fjala për ju sërish.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
7 PY. Na thatë, i thatë Trupit Gjykues që vëllezërit romë janë
8 rrahur. Më herët na thatë gjithashtu që kur u kthyen nga puna
9 që bënë "ata ju tregonin" se çfarë bënë. A kanë përmendur
10 ndonjëherë ata apo a e dini në qoftë se janë keqtrajtuar
11 ndonjëherë ata ndërkohë që ishin jashtë dhome, a janë
12 keqtrajtuar edhe kur ishin jashtë dhome?

13 PË. Jo, nuk e kam vërejt për vete.

14 PY. Na thatë që të kanë rrahur dhe ty vetë njëherë.

15 Dëshiroj t'ju bëj ca pyetje lidhur me këtë.

16 Përpara sesa të kalojmë tek keqtrajtmet që ke pësuar ti
17 vetë, dëshiroj t'ju pyes: A ka pasë ndonjë ndërmjet këtyre
18 personave që ishin të ndaluar bashkë me ty që ndonjë tjetër,
19 domethënë, që është rrahur?

20 PË. Po. Të gjithë jemi rrahur çka kemi qenë në dhomë me rend,
21 pa dallim.

22 PY. Po flet për rrahjet që kanë ndodhur brenda dhomës ku
23 mbaheshit të ndaluar?

24 PË. Po.

25 PY. Më herët na thatë ose përmendët fjalën marrje në pyetje.

1 Dëshiroj t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë, me marrjen në
2 pyetje.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Prokuror.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Referencën.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk e kam për momentin. Po do
8 jua jap në momentin e parë që ta kem gati.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

12 PY. Me sa dini ju, ku janë zhvilluar këto marrje në pyetje,
13 ku bëhej marrja në pyetje brenda në dhomë apo jashtë dhome?

14 PË. Jashtë dhome. Nuk e di se ku. Jashtë.

15 PY. Po ty vetë a të kanë nxjerrë jashtë dhome për të marrë në
16 pyetje?

17 PË. Po, vetëm njëherë më kanë nxjerrë.

18 PY. Kë tjetër ndërmjet atyre njerëzve që ishin të ndaluar dhe
19 që për të cilët kemi diskutuar sot, domethënë, kë tjetër kanë
20 nxjerrë nga dhoma dhe e kanë marrë në pyetje?

21 PË. Po, pi dhomësh më kanë nxjerrë, në tjetër, na kanë çu
22 tjetërkund.

23 PY. A të kujtohet, se diskutuam pak më herët, na dhatë
24 hollësi lidhur me identitetin e disa prej personave që ishin
25 të ndaluar bashkë me ju. A të kujtohet nëse ndonjë prej

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 96

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 personave që diskutuam sot është nxjerrë nga dhoma për t'u
2 marrë në pyetje?

3 PË. Po.

4 PY. A të kujtohet kush ishte ky person?

5 PË. Po kanë qenë disa persona, tre a katër shka janë marrë në

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull. Të nderuar
11 Gjykatës, a --

12 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I vëllai?

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] -- mund të kalojmë në seancë
14 private?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
16 lutem mos flisni më, z. Dëshmitar.

17 Sekretar, na kaloni në seancë private ju lutem.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 97

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 98

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 99

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
15 të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Mirë se u ktheve, Dëshmitar dhe faleminderit për durimin.
19 Na u desh ta ndërpresim për pak kohë.

20 Tani do t'ia jap fjalën përsëri Prokurorit. Dhe e vendosë
21 ai nëse ka nevojë të kthehem në seancë private, meqë u
22 ndërpreme, apo të vazhdojë në seancë publike.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është e vështirë të vendosësh,
24 por mendoj që siguria e dëshmitarit është e para. Do të bëjmë
25 disa pyetje vijuese përsëri në seancë private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 101

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull. Po kthehem në seancë private.

3 Të kalojmë ju lutem në seancë private.

4 Dhe pastaj do të kemi dhe dhjetë minuta, do të punojmë
5 mbas orës 4.00.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë private)

Faqe 102

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

[Seancë e hapur]Riklasifikuar në bazë të F579

5 PY. Z. Dëshmitar, na ke thënë se njerëzit janë rrahë dhe në

6 dhomë, se i kanë nxjerrë prej dhome, i kanë sjellë përsëri,

7 duke u dridhur, me shenja që tregonin se ishin rrahë. Si je

8 ndjerë si pasojë e gjithë kësaj dhune që ke pa ndaj njerëzve

9 që ishin të ndaluar aty bashkë me ty?

10 PË. Po normal që jam ndi i frikësuar. Jam ndi i frikësuar

11 shka do të ndodhë edhe me mu. Se e dijsa shka i ka ndodhë

12 atyne, po shka të më ndodhë edhe mu. Kështu që kam qenë i

13 frikësuar boll.

14 PY. Mbase ky është momenti që të diskutojmë atë që të ka

15 ndodhë ty.

16 Na thuaj se kur je trajtuar ti vetë, siç përmende më

17 herët gjatë dëshmisë.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe, të nderuar Gjykatës, mund

19 ta bëjmë edhe në seancë publike këtë gjë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Të kalojmë në seancë publike, ju lutem.

23 ~~{Seancë e hapur}~~

24 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Vazhdoni, z. Prokuror.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Z. Dëshmitar, po e përsëris edhe njëherë pyetjen. Jemi në
5 seancë publike, por duke i treguar Gjykatës për ato që ke heq
6 për keqtrajtimin, nuk do të identifikohesh dot.

7 Pra, siç po thosha, a mund t'i thoni Trupit Gjykues për
8 kohën që jeni keqtrajtu vetë. Kur ka ndodhë kjo për herë të
9 parë?

10 PË. Po ka ndodhë, dy herë rasti ka ndodhë. Ditën ka ndodhë.
11 Një herë me shufër gome në shpinë më ka ra, s'e kam pa kush ka
12 qenë. Dhe njanin në synin e djathtë ku dhe më ka dhimb shumë
13 syni dhe kam pasë dhimje të madhaja dhe lëndime të mëdhaja në
14 sy. Kështu që dy herë unë kam qenë i keqtrajtu në dhomë.

15 PY. Këto kanë ndodhur në të njëjtën herë, pra, me shkopin e
16 gomës dhe me atë gjuaajtjen në sy, apo në ditë të ndryshme të
17 ndalimit tënd?

18 PË. Në ditë të ndryshme ka qenë. Brenda tri-katër ditëve. Ka
19 pasë dallim.

20 PY. Tani do t'ju pyes për herën e parë që ka ndodhë.

21 A e mban mend nëse hera e parë të goditën në sy apo kur
22 të goditën, të qëlluan me shkop gome, kush qe e para?

23 PË. Me shkop gome së pari. Së dyti herë me grusht në sy.

24 PY. Në cilën pjesë të trupit të qëlluan me shkopin e gomës?

25 PË. Në shpatullën e djathtë të krahut.

1 PY. Ishte një goditje e fortë?

2 PË. Një goditje. Vetëm një goditje ishte.

3 PY. E ndjeve?

4 PË. E ndjeva pak. Si ëndërr më erdh.

5 PY. Mbasi të goditën pate ndonjë pasojë, të dhëmbi për një
6 kohë të gjatë? Pate ndonjë pasojë për gjithë shëndetin tënd?

7 PË. Po. Kam pasë nja dy-tri ditë dhembje kam pasë. Po.

8 PY. A munde me e njof personin që të goditi me shkopin prej
9 gome?

10 PË. Jo, se ishin të kthym ka zidi kryet. E kishim pasë të
11 kthym ka zidi, jemi kanë të kthy aty.

12 PY. Tani të flasim për incidentin tjetër kur të keqtrajtuan,
13 që the se ndodhi pas tre-katër ditësh mbas herës së parë, kur
14 të qëlluan me grusht në sy.

15 A mund t'i tregosh Gjykatës se çfarë të kujtohet nga ai
16 incident?

17 PË. Po ishim në mëngjes. Se ora s'e di, përafërsisht 9.00 a
18 10.00. Hinë nja tre persona civilë dhe na i ulën kryet që mos
19 me mujt me pa. Dhe nuk e di qysh kryt i kam pasë të ulët, veç
20 kur kam pa dhimtë e syni mu mshel dhe me më ra me grusht. Fort
21 më ka ra me grusht qashtu, që mu mshel syni brendi. Më nuk di
22 gjë. S'kam pa gjë ma.

23 PY. Përpara ose mbasi të kanë goditë, a të kujtohet a kanë
24 thënë gjë këta njerëz, këta persona, a të kanë bë ndonjë
25 pyetje?

1 PË. Jo, vetëm ua kemi ndi zanin tuj thanë "spiuna", "spiuna",
2 "tradhtarë" q'aq. Qatë za e kam ndi.

3 PY. Kujt ju drejtuan me këto fjalë "spiuna", "tradhtarë",
4 kujt ia drejtuan ato fjalë?

5 PË. Me siguri krejtëve neve. Me siguri tanë shka kemi qenë
6 aty.

7 PY. A e mban mend, përveç teje, a u rrehen dhe të tjerët atë
8 ditë?

9 PË. Janë rrahë krejt. Po, të vërtetën me thënë, unë nuk kam
10 mujt me çu kryet me i pa.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Dëshmitar, mendon se mund të vazhdojmë ende me pyetjet?

13 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

17 PY. Kjo goditja në sy, ta nxiu syrin, të shkaktojë ndonjë
18 lëndim të dukshëm fizik, përveç faktit që nuk arrije dot me
19 pa, siç i the Trupit Gjykues?

20 PË. Po. Mu nxi syni dhe mu ënj shumë dhe kam pasë pak
21 gjakderdhje pi synit.

22 PY. Ky grushti të shkaktoi ndonjë pasojë që zgjati më shumë
23 se ato dy-tre ditë? Ke pasë ndonjë dëmtim më afatgjatë si
24 pasojë e atij grushti?

25 PË. Po sot edhe atëherë më loton ky syri. Më loton shpesh.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 106

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 Kështu që dhimë nuk kam, po më loton. Ende më loton.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Propozoj që të ndiqni të njëjtën procedurë. Të lexoni atë që
4 është përkthyer.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

6 PY. Ka pasur një problem teknik, prandaj do ta lexojmë dhe
7 njëherë përgjigjen për të parë nëse mungon diçka.

8 Unë dëgjova që:

9 "Dhe atëherë dhe tani më loton syri. Pra, ka pasur,
10 pasojat vazhdojnë dhe sot".

11 Kaq the, kjo ishte përgjigja apo the dhe diçka tjetër që
12 ne nuk e kapëm?

13 PË. Jo, kaq. Shka ndëgjuat.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
15 mirë.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

17 PY. A ju kujtohet ndonjë rast tjetër, për shembull, a ndodhi
18 ndonjëherë që të kishte, të ushtrohej ndonjë dhunë tjetër,
19 përveç kësaj që na përshkruat, ndaj jush apo të tjerëve, të
20 ndaluarve të tjerë në atë dhomë?

21 PË. Po ka pasë edhe një keqtrajtim i romëve në dhomë që e
22 kanë rrahë. Përveç atij, nuk ka pasë më tjetër problem.

23 PY. A erdhi ndonjëherë njeri në dhomë dhe ju ka urdhëruar për
24 t'i bërë gjëra njëri-tjetrit?

25 PË. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 107

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 PY. A mund të na thoni se çfarë ju kanë detyru me ba?

2 PË. Na kanë detyru shoqi-shoqit me i ra në shuplakë, sa të

3 mujshim sa më shumë mujsh me i ra.

4 PY. Kush ju ka detyru ta bënit këtë, a ju kujtohet?

5 PË. Nja dy persona kanë hi civilë aty dhe na urdhëruan me

6 rend me ra shoqi-shoqit me i ra.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kuptoj që kemi 10 minuta mbas

8 orës 4.00 më shumë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

10 keni në qoftë se ju nevojitet.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Por unë kam edhe 15 minuta

12 afërsisht. Mbase mund të kem nevojë për 10 minuta më shumë për

13 të përfunduar pyetjet.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

15 kemi dyqan ushqimor këtu, nuk e masim me gramë kohën.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po do të futem në një fushë

17 tjetër pyetjesh, kështu që nuk dua ta ndërpres, mbase do të

18 ishte më mirë të përfundonim tani, të mos i shfrytëzojmë

19 dhjetë minutat e tjera. Dhe të vazhdojmë nesër dhe besoj që do

20 të përfundojë rreth 25 minuta më vonë pasi të filloj.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

22 të vazhdojmë ashtu. Edhe duke pasë parasysh se ka qenë një

23 ditë e gjatë me pyetje, mbase është më mirë që ta ndërpresim

24 këtu dhe të vazhdojmë nesër.

25 Z. Dëshmitar, tani ndërpresim seancën për sot dhe do të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-11 (Seancë e hapur)

Faqe 108

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 vazhdojmë nesër me pyetjet e Prokurorisë duke filluar në orën
2 9.30.

3 Dua t'ju falënderoj për kohën tuaj sot, ka qenë një ditë
4 e vështirë. Shpresoj që të mund të pushoni sot pasdite dhe në
5 mbrëmje dhe do të shihemi përsëri nesër bashkë. Dhe më lejoni
6 t'ju kujtoj që këto gjëra nuk duhet t'i diskutoni pra, këto që
7 keni thënë këtu në këtë sallë gjyqi me askënd.

8 Faleminderit shumë. Dhe Sekretarja do t'ju shoqërojë të
9 dilni nga dhoma.

10 Faleminderit.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes
12 videolidhjes]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
14 t'ju pyes të gjithë palëve.

15 Z. Prokuror, keni ndonjë gjë që doni ta diskutoni si
16 Prokurori me ne si Trup Gjykes?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mbrojtësi i Viktimave?

20 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Mbrojtja e pashë që u ngritët. Keni fjalën.

23 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Sa për të korrigjuar
24 diçka në transkript. Në faqen 92 të transkriptit të sotëm te
25 rreshti 5, u përmend "z. Shala" në vend të "Dëshmitar". Është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 109

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F500RED dhe F579

1 një mospërputhje e vogël, po mendoj që duhet ta vëmë në dukje.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Përsëriteni dhe njëherë rreshtin?

4 Z. AOUINI: [Përkthim] Rreshti 5.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

6 transkript vërtetë është shkruar "z. Shala" dhe, në fakt,

7 ishte pyetje drejtuar dëshmitarit. E shënuam për procesverbal.

8 Shumë mirë.

9 Ndonjë gjë tjetër që doni të ngrini me Trupin Gjykues?

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo. Faleminderit shumë, e

11 nderuar.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

13 mirë atëherë. Edhe njëherë falënderoj përkthyesit, punonjësin

14 e sigurisë, stenografen. Dhe nesër rishikohemi në orën 9.30.

15 --- Seanca mbyllet në orën 16.02

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25